



Nr. regj. 37291/2011

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurës Kimete (Shaip) Bytyqi, nga Suhareka, për kundërvajtjen nga neni 7 ndëshkuar me nenin 16 paragrafi 1 pika 1.2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik e Pasurisë, Nr. 03/L-151, në bazë të nenit 73,74, 195, 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet GZ KSAK 23/79, me datë 30.12.2011 merr këtë:

AKTVE N D I M

E PANDEHURA: Kimete (Shaip) Bytyqi, e lindur më 24.08.1965 në Samadrexhë KK Suharekë, me vendbanim në Suharek-Shirokë, ka të kryer fakultetin e gjuhës dhe letërsisë shqipe, e ve, e gjendjes së mesme ekonomike, më parë e padënuar,

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s e

1. Sepse pas emërimit në pozitën e deputetes së Kuvendit të Kosovës, më datë 21 korrik 2011 nuk e ka bërë deklarin e pasurisë me marrjen e detyrës së deputetes, -
 - me këtë veprim ka kryer kundërvajtjen nga neni 7 ndëshkuar me nenin 16 par 1 pika 1.2 të Ligjit për Deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave të Zyrtarëve të Lartë publik, andaj i shqiptohet

D Ë N I M

Me gjobë në shumë prej 300 (treqind) €, të cilën gjobë ka për të paguar në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktvendim të marrë formën e prerë, në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së, Nr. 1000-4300-7000-0518. Paga bëhet në ndonjërin agjenci-Bankë për mbledhjen e të hyrave, përmes urdhërpagesës së plotësuar nga Gjykata. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë e njëjta do ti zëvendësohet me dënim burgu në kohëzgjatje prej **20(njëzetë) ditësh**, duke llogaritur për çdo **15 €**, nga **1(një) ditë** burgu.

Shpenzime të procedurës nuk ka pas, kurse në emër të paushallit gjyqësor e pandehura është e obliguar ta paguaj shumën prej nga **5 €**, në afat dhe xhirrollogari të njëjtë me gjobën.

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurës dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsion në Prishtinë, i parashtrori kësaj gjykate kërkesën nr. 01-4112/2011 me datë 26.10.2011 për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj Kimete (Shaip) Bytyqit, nga Suhareka, për kundërvajtjen nga neni 7 ndëshkuar me nenin 16 par 1 pika 1.2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik, duke kërkuar që e njëjta të shpallët përgjegjëse dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjyqtaria filloi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të pandehurës e cila në mbrojtjen e vet deklaroi se nuk ka pas njohuri se me marrjen e detyrës së deputetes duhet të deklaronte pasurinë dhe se asnjëherë nuk e ka njoftuar askush për këtë obligim. Detyrën e ka marr më 21 korrik 2011, pastaj në muajin gusht kanë qenë pushimet vjetore për deputet dhe më vonë përmes mediave ka kuptuar se duhet ta deklaronte pasurinë të cilën e ka deklaruar me vonesë dhe atë më datë 28 tetor 2011. Konsideron se nuk është përgjegjëse pasi nuk ka pas njohuri se duhet të deklaronte pasurinë.

Për vërtetimin e gjendjes faktike gjyqtaria ftoi Nexhat Jasharin i cili punon në Zyrën e personelit në Kuvend i cili ka qenë pika kontaktuese, i njëjti deklaroi se ka dërguar listën e deputetëve të cilët janë zëvendësuar dhe se nuk ka kontakt të drejtpërdrejt me deputet andaj nuk ka kontaktuar me deputeten Kimete Bytyqi. Çështja ka qenë e sensibilizuar një vit më parë dhe ligji ka kaluar nëpër Kuvend kështu që ka konsideruar se e njëjta ka njohuri lidhur me deklarinimin e pasurisë. Zakonisht Agjencia kundër korrupsion dërgon i-mail kur ndonjë deputet nuk e deklaron pasurin por në këtë rast nuk ka pranuar asnjë i-mail, ka marr vetëm konfirmimin dhe falënderimin që i ka dërguar emrat e deputetëve të zëvendësuar nga kjo Agjenci, andaj ka konsideruar se e njëjta e ka kryer obligimin.

Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimi i deklaratës së të pandehurës si dhe vërtetimit me numër të protokollit 03-4180/11 të datës 28.10.2011 i lëshuar nga Agjencia Kundër Korrupsionit dhe vlerësimi të shkresave të tjera të lëndës, secilës veç e veç dhe të gjithave së bashku, gjyqtarja konstatoj këtë gjendje faktike: se e pandehura Kimete Bytyqi si deputete nuk e ka deklaruar pasurin me marrjen e detyrës së deputetes më datë 21 korrik 2011, andaj në masë të mjaftueshme vërtetoi se ka kryer kundërvajtjen e cila me kërkesë i vihet në barrë, pasi që mosnjohja e Ligjit nuk e liron nga përgjegjësia, poashtu gjatë vitit 2010 kjo çështje ka qenë mjaft e diskutuar në media nga Agjencia.

Me rastin e shqiptimit të dënimit gjyqtaria vlerësoi të gjitha rrethanat nga neni 7 LMK, peshën e veprës kundërvajtëse, personalitetin e të pandehurës, shkallën e përgjegjësisë, si rrethanë lehtësuese murr faktin se e njëjta e ka deklaruar pasurin më vonë dhe atë më datë 28.10.2011, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti, andaj i shqiptoi një dënim si në dispozitiv të këtij aktvendimi me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet efekti pozitiv i sanksionit dhe e pandehura në të ardhmen nuk do të kryen kundërvajtje të tilla apo të ngjashme.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË
Nr. Regj. 37291/2011, më datë 30.12.2011

Gjyqtaria
Azra Cakolli

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh, Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, nga data e pranimi të të njëjtit nëpërmjet kësaj gjykate, pa taksa.